



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS**  
**REKTORATI**

Tiranë, me 09.10.2019

**N J O F T I M**

Mbështetur në Vendimin e Rektoratit Nr. 134 datë 09.10.2019 “Për pranimin e 1 (një) punonjësi si personel akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2019 – 2020, ne Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes”, njoftohen të gjithë kandidatët e interesuar që duan të aplikojnë për personel akademik me kohë të pjesshme (pedagog të jashtëm), që duke filluar nga **data 09.10.2019** deri më **14.10.2019**, duhet të dërgojnë më anë të shërbimit postar në Protokollin e Universitetit të Sporteve të Tiranës dokumentacionin përkatës.

**Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit**  
**1 (një) “Lektor” me kohë të pjesshme:**

- **Lenda:** “Organizim dhe Menaxhimi – Marketing Sportit”  
**Moduli:** “Menaxhim- Marketing Sportit” (Bachelor)

**Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:**

- Të ketë përfunduar studimet pranë Universitetit të Sporteve (Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes) me kohë të plotë.
- Nota e mesatare e ciklit të parë të studimeve (Bachelor) duhet të jetë mbi 8-të;
- Të zotërojë një gjuhë të huaj (preferohet gjuha angleze).
- Të ketë njohuri për njohjen e programeve bazë kompjuterike.
- Të ketë së paku gradën “Doktor i Shkencave”
- Kanë preferencë pedagogër më grada e tituj : Prof.Asc.Dr.
- Preferohen pedagogët që kanë pervojë në mësimdhënie në shkollën e lartë.
- Fusha e studimit dhe diplomimit duhet të përputhet me lëndën mësimore që do të zhvillojnë sipas departamentit ku aplikon.
- Të kete veprimtari shkencore si: referime, botime, studime.
- Vlerësohen kualifikime të ndryshme në nivel pasuniversitar që i përkasin fushës së lëndës në departamentin ku aplikon.

Të interesuarit duhet të dërgojnë më anë të shërbimit postar në Protokollin e Universitetit të Sporteve të Tiranës këto dokumenta:

- Curriculum Vitae (e detyrueshme).
- Diplomën dhe Certifikatën e notave të studimeve Bachelor (fotokopje)
- Diplomë dhe Certifikatën e notave të studimeve Master i Shkencave ose DIND (fotokopje) (e detyrueshme)
- Certifikatën e gradës Doktor i Shkencave (fotokopje)
- Dëshminë e titullit Profesor i Asociuar (nqs ka) (fotokopje)

- Dëshminë e titullit Profesor (nqs ka) (fotokopje)
- Të vërtetojë që nuk është i dënuar penalisht (vetëdeklarim) (e detyrueshme)
- Fotokopje të kartës së identitetit (*fotokopje*) (e detyrueshme)
- Numrin e llogarisë bankare. (nqs ka)
- Vërtetim nga qendra e punës për t'u angazhuar si pedagog me kohë të pjesshme në institucionin tonë. (nqs është i punësuar) (e detyrueshme) si dhe leja nga titullari i institucionit ku punon.
- Librezë shëndetësore nga Qendra Shëndetësore (dorëzohet nëse shpallet fitues).

Vetem paketat e aplikimit të mbërritura me anë të shërbimit postar pranohen dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të kandidatëve.

Në zarf duhet të shënohet adresa e sakte e aplikimit; Universiteti i Sporteve të Tiranës, Fakulteti, Departamenti, **lenda ku aplikon**, emri, mbiemri, Nr. telefonit dhe e-mail e konkurentit.

Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.

**REKTOR**

**Prof. Dr. Agron CUKA**